



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

V E N D I M

Nr.01 Date 15.09.2010

Per:

Anullimin e vendimit Nr.07 date 17.06.2010 per devijimin e Rrjedhjes se lumit Mat ne Milot ne zonen midis Urave, sipas reklamimit te bere nga MMPA Ujrave.

Ne mbeshtetje te nenit 8 te ligjit nr.8093 dt. 21.03.1996 "Per Rezervat Ujore" dhe te vendimit nr. 3 date 09.01.2003 te Keshillit Kombetar te Ujit "Mbi procedurat e dhenies dhe te rinovimit te lejeve per shfrytezimin e zhavorreve dhe rerave nga shtreterit e lumenjeve", Keshilli i Basenit Ujembledhes Mat, **me vendim Nr.07 date 17.06.2010** vendosi qe te miratoje propozimin per nderhyrje ne zonen e ndaluar. Projektin duhej ta punonte Bordi Kullimit Lezhe, Komuna Zejmen dhe Komuna Milot per devijimin e rrjedhes se lumit Mat ne fshatin Pllane ku goditet argjinatura e rruges, ne Milot ku eshte demtuar vepra marrjes se kanalit vadites dhe ne Gajush ku rrjedha e lumit eshte perqendruar ne drejtim argjinaures se mbrojtur me investime te shtetit vitin e kaluar. Sipas ligjit neve kemi derguar dosjen me vendimet e aprovuara ne MMPA Ujrave **nga ku** per vendimin **Nr.07 date 17.06.2010** eshte argumentuar se bie ndesh me V.K.K.Ujit nr.01 date 13.01.2010 dhe se kjo procedure per kete rast duhet ti nenshtrohet procedures se re ne K.K.Ujit ku Bordi Kullimit, Komuna Zejmen dhe Milot duhet te sjellin zyrtarisht kerkesen e tyre me projektet perkatese per nderhyrje. Per sa me siper Keshilli Basenit Mat,

V e n d o s i:

1. Anullimin e vendimit **Nr.07 date 17.06.2010** Nr.04 date 02.02.2010,
2. Te ngarkohet Bordi Kullimit Lezhe ne bashkpunim me Komunat Zejmen dhe Milot qe te hartoje te gjitha dokumentacionin qe kete kerkese te ia dergojme K.K.Ujit per aprovim.
3. Ngarkohet AUB Mat per zbatimin e ketij vendimi. Te bashkpunoje me INUK, ARM dhe Grupin Task-Force per ndalimin e shfrytezimit te inerteve ne zonen e ndaluar.
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B. MAT
Pashk NDOCI



KRYETARI I K.B.U. MAT
Pal DAJCI

